



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE  
BORDI

VENDIM

Nr. 114, Datë 26.04.2021

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË  
PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA GJENERATORET  
E VEGJËL ME BURIM TË RINOVUESHEM NGA PJESA E BIODEGRADUESHME E  
MBETJEVE TË NGURTA, QË SHFRYTËZOJNË MBETURINA INDUSTRIALE,  
URBANE DHE RURALE, PËR VITIN 2020**

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, të Ligjit nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 27, datë 17.1.2018 “Për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e vegjël me burime të rinovueshme nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale”, dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 26.04.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 58/2 prot., datë 26.04.2020 të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020”,

**Konstatoi se:**

- ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 2 MW dhe me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike deri në 3 MW për energjinë e erës, në përputhje me metodologjitë e miratuara nga Këshilli i Ministrave.
- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 271, datë 28.12.2020, vendosi fillimin e procedurës “Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020”.
- Përpara kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 1249 prot., datë 07.12.2020, i ka kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) informacion në lidhje me Autorizimet paraprake apo Miratimet përfundimtare që janë dhënë nga kjo e fundit, gjatë vitit 2020 në lidhje me ndërtimin e veprave për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet

e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, si dhe për gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale.

- MIE me anë të shkresës nr. 1249/1 prot., datë 29.12.2020 është shprehur se bazuar në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, nuk ka lëshuar asnjë miratim përfundimtar për ndërtimin e veprave nga burime të vogla të rinovueshme nga gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Mbyllet e procedurës mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga gjeneratorët e vegjël me burim të rinovueshëm nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturina industriale, urbane dhe rurale për vitin 2020.
2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Autoritetin e Konkurrencës (AK) si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL sh.a) për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**